



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 17.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të datës 14.10.2024, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: Medi Health L.L.C.;Greemed, lidhur me Lot 2 dhe Lot 3 të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë" me Nr. të Prok: 206-24-8799-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik: **Medi Health L.L.C.;Greemed**: lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë" **Lot 2 dhe Lot 3** me nr. prokurimi 206-24-8799-1-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 09.10.2024 të publikuar në platformën elektronike.
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 09.10.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Medi Health L.L.C ; Greemed, me datën 14.10.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë" **Lot 2 dhe Lot 3** me nr. prokurimi 206-24-8799-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datën 17.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas Grupit të Operatorëve Ekonomik: Medi Health L.L.C.;Greemed:

Ligji për prokurim publik, nr 04/L-042 i amandamentuar meligjet tjera

- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 11 Informatat Sekrete Afariste
- Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit
- Neni 28 Specifikimet teknike
- Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Rregullorja për prokurim publik nr. 001/2022

- Neni 7 Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion
- Neni 38 Sqarimi i Tenderëve
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 97 Shkeljet e rënda

Pretendimi ankimore te Grupit te Operatorëve Ekonomik: Medi Health L.L.C.;Greemed:

Operatori Ekonomik “Medi Health” LLC si lider i Grupit te OE ofertues ne te cilen gjindet edhe OE Greemed shpk, pjesemarres dhe ofertues ne këtë procedur te prokurimit ne Lot 2 dhe Lot 3, pas publikimit te njoftimit te AK – MSH, vendimit dhe propozimit për dhënie te kontratës kemi kerkuar qasje ne ofertën e OE te propozuar për dhënie te kontratës fillimisht me datën 09.10.2024, me pas edhe me daten 10.10.2024.

Oferta e propozuar për dhënie te kontratës ne Lotin 2 dhe Lotin 3 “Ko Med” LLC, për proceduren e prokurimit me titull: *“Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” – LOT 3* dhe nr. prok: 206-24-8799-1-1-1, është tërësisht e pa pergjegjeshme, prandaj bazuar ne nenin 108/A te LPP-se dhe ne afatin e parapare me ligj paraqesim kete Kerkese per Rishqyrtim me faktet dhe deshmit tona si ne vijim:

Pretendimi Ankimore 1.

Pas publikimit te vendimit mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit, ne si OE pjesemarres ne këtë procedure te prokurimit pikerisht me datën 09.10.2024, kemi kerkuar qasje ne dokumentet – ofertën e teresishme te OE te propozuar për dhënie te kontratës ne Lotin 2 dhe Lotin 3.

AK – MSH, përkundër kerkeses për qasje te teresishme dhe përkundër bazes ligjore ka mohuar ofrimin e qasjes dhe na ka ofruar vetem disa nga dokumentet bazike te kompanise dhe nuk na eshte ofrar qasja e plote. me këtë është mohuar dhe tentohet te vazhdohet tutje me oferte te pa pergjegjeshme dhe te lidhet kontrate kundërligjore.

Si rrjedhoje ne si OE te njejten kerkese e kemi perseritur edhe me datën 10.10.2024, prova këto te cilat ju si AK i dispononi dhe i keni pranuar përmes emaileve, kerkese per te cilen nuk kemi marr pergjegje.

Mohimi i qasjes ne dokumentacion publik është shkelje esenciale e ligjit për prokurim publik, nr 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligje tjere.

Neni 10 dhe 11, i LPP-se, përkatësisht nenit 7, i rregullores për prokurim publik, trajton qeshtjen e dokumentacionit afarist.

Kompania jone është pale ne procedure dhe disponon interes juridik i përcaktuar me nenin 4.1.26 te LPP-se

Katalogjet, broshurat, certifikatat dhe deklaratat tjera qe kane te bëjnë me specifikacionet teknike te detyrueshme, bazuar ne dispozita ligjore për prokurim publik janë kërkesa qe rrjedhin nga neni 66, pershtatshmeria profesionale dhe nga neni 70 i LPP-se, standardet për sigurimin e cilesise.

Dispozita te nenit. 11, i LPP-se, paragrafi 3, pika 3.3 dhe 4, përcaktojnë qe: *“OE, i cili deklaron ofertën konfidenciale duhet te argumentoi përmes deklaratës me shkrim, ku domosdo duhet te vërtetohet se ndonjëri nga elementet e tenderit nuk është prone publike dhe te dhënat mbrohen dhe ne detaje do te arsyetohet konfidencialiteti apo sekreti ku zbulimi i tyre do te rezultonte me dëmtim material apo komercial te operatorit ekonomik”.*

Secili prodhues katalogjet, broshurat dhe qeshtjet tjera te cilat lidhen me cilesine e produkteve i kane publike madje edhe ne uebfaqe te tyre. Mohimi i qasjes për dokumente ligjerisht te qaseshme tregon për mos pergjegjesi profesionale.

Ne anen tjetër paragrafi 4 i nenit 11, te LPP-se përcakton se:

“Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste”.

Kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, aspekti administrativ, ISO Certifikatat, aspekti teknik dhe te dhenat e produkteve, katalogjet dhe broshurat e produkteve, nuk mund te klasifikohen si sekret afarist, pasi ato gjinden publike me kerkime te thjeshta ne internet.

Ligjërishit sekret afarist mund te konsiderohen vetëm te dhënat personale. AK - MSH, zyra e Prokurimit, ne kuptim te paragrafit 4 te nenit 11 te LPP-se, është dashur ta përgatise versionin e pastruar te dokumenteve ndaj OE-ve te cilët i kane deklaruar ofertat e tyre si te tilla. Rrjedhimisht me mos ofrim te qasjes, ju si AK - MSH, keni shkelur edhe dispozitat e nenit 10 te LPP-se - mjetet për promovimin e transparencës.

E drejta për qasje ne dokumente publike është e drejte bazike madje e garantuar me Kushtetute te Republikës se Kosovës, e qe sipas nenit 41 perkufizohet qe:

- 1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.*
- 2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.*

Neni 97 i Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022, pika C), mos ofrimin e qasjes e klasifikon si shkelje te rende te ligjit për prokurim publik.

c) Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Qasja e plote ne dokumente publike është e garantuar edhe me nënparagrafin 3.2, te nenit 17 te ligjit nr. 06/L081, për Qasje ne Dokumente Publike, si dhe me nenin 12, 13 dhe 14, te ligjit nr. 06/L-082, për Mbrojtjen e te dhënave personale.

OE ankues se bashku me këtë kerkese ne te njejten kohe do te raportojmë ne organe dhe agjencione perkatese për veprime kundërligjore, shkelje te parimeve dhe tentativ për keqperdorim dhe abuzim te paras publike.

- Për këtë qeshje OSHP, ka nxjerr disa vendime ku mohimi i qasjes ne dokumente publike është gjykuar ndryshe nga AK.
- Ne ueb faqen e OSHP-se mund ti referoheni vendimit me nr. 606/23 ; 877/23 e shum vendime tjera.
- Për mos ofrim te qasjes ne dokumente publike edhe Agjencia për Informim dhe Privatesi ka te nxjerra me dhjetra vendime për mos ofrim te qasjes madje edhe shqiptim gjobash.
- Ne ueb faqen e AIP gjeni shum vendime mesin e tyre vendimet me nr. 770/2024; 875/2024 e shum te tejere.

Pretendimi Ankimore 2.

Operatori Ekonomik i propozuar për dhënie te kontratës ne Lot 2 dhe Lot 3 te kesaje procedure te prokurimit është i pa pergjegejshem, ky fakt tregohet vetëm nga një dokument i vetëm i pranuar nga ne si OE gjate qasjes se ofruar i titulluar “**Deklaratë për Specifikacione Teknike te Detyrueshme**”.

- Ne si kompani kemi dorëzuar një broshurë bazike të prodhuesit, andaj kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni Vlerësues që gjatë vlerësimit të ofertës tonë nëse ka nevojë për ndonjë sqarim apo informacion shtesë, ju lutem na kërkon sqarime dhe ne jemi të gatshëm të ju ofrojmë sqarime në bazë të nenit 72 dhe 59.2 të LPP-së dhe nenit 39 të RrUOPP-së.

Ne te njejten deklarate vet kompania e propozuar për dhënie te kontratës tregon se nuk janë te paraqitura specifikimet teknike te detyrueshme, tregohet se janë paraqitur broshura bazike për specifikacione teknike te detyrueshme, madje kerkohet nga AK, qe përgjatë vleresimit te ofertave te kerkohet sqarim sipas nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Ne piken 91. Dhe 9.2 te FDT-se, tek kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ne kerkesen nr. 2 është kerkuar:

“Operatori Ekonomik duhet të prezantojë katalogun (broshurën) e pajisjeve të ofruara, ku produktet dhe specifikat teknike të ofruara duhet të jenë të nënvizuara qartë. Në rast se

prezantohet broshura, duhet të specifikohet edhe linku i faqes zyrtare të prodhuesit ne internet, ku mund të gjendet kjo broshurë”.

Dëshmia 2. *“Katalogu (broshura) e pajisjeve të ofruara me selektim të qartë të produkteve dhe specifikave teknike të ofruara, së bashku me linkun e faqes se prodhuesit.*

Pra ju si AK, përveç ofrimit të të gjitha produkteve të cilat janë të shumta në të dy lotet e kontestuara, keni kërkuar që të bëhet selektimi i qarte i produkteve dhe specifikave të ofruara së bashku me linkun e faqes prodhuese.

Dokumentet e derguara pas kërkeses për qasje, gjegjësisht në lidhjen e ofertes që gjenerohet nga sistemi eprokurimi, kemi vërejtur prodhuesit me të cilët ka ofertuar OE KoMed për Lot 2 dhe Lot 3.

Pikerisht në linkun e faqes së prodhueseve me të cilët ka ofertuar gjegjësisht është rekomanduar për dhënie të kontratës OE “Ko Med” LLC nuk i ka të prezantuara produktet konform kërkesave të Dosjes së Tenderit

Gjate hulumtimit në web faqet zyrtare të kompanive prodhuese kemi vërejtur këto mangësi në produktet e ofruara në krahasim me kërkesat e FDT:

Per Lot 2:

Nuk janë ofruar të gjithë instrumentet e kërkuara sipas Dosjes së Tenderit.

Per Lot 3:

Per piken 1 të Lotit 3 – Aparatet për Dializë prodhuesi Dialife në broshurën që gjendet në web faqen e kësaj kompanie nuk i prezanton këto pika:

- Pika 5 e kërkesave të specifikimit teknik – *It should have Sequential Ultra Filtration Facility*
- Pika 7 e kërkesave të specifikimit teknik – *It should have Single Needle Dialysis Facility optional Double Needle Dialysis Facility*
- Pika 8 e kërkesave të specifikimit teknik – *it should have Volumetric or Flow Ultrafiltration System.*
- Pika 12 e kërkesave të specifikimit teknik – *It should have Blood leak Sensor which can differentiate between impurities and real blood.*
- Pika 13 e kërkesave të specifikimit teknik – *Should accept different concentrates formulation. Different Dialyzers and blood tubing sets.*
- Pika 15 e kërkesave të specifikimit teknik – *It should have self test facility during treatment.*
- Pika 21 e kërkesave të specifikimit teknik – *Display Parameters dhe Alarm (nuk janë të cekur)*
- Pika 24 e kërkesave të specifikimit teknik – *Facility for disinfection History/Log*
- Pika 25 e kërkesave të specifikimit teknik – *It should have Ultrafiltration and Sodium Profiling facility.*
- Pika 27 e kërkesave të specifikimit teknik - *Blood pressure monitoring – Systole 40-260mmHg dhe Diastole 20-200mmHg.*

Prove: Dëshmi nga Katalogu i prodhuesit të publikuar në web faqe.

Per piken 2 te Lotit 3 – Shtreter të HD me tavoline (set) komplet prodhuesi Digiterm duke pretenduar qe OE i propozuar per kontrate ka ofruar shtratin me peshore ne broshuren qe gjindet ne web faqen e kesaj kompanie nuk i prezenton keto pika qe jane kerkuar ne Specifikimet teknike te detyrueshme ne FDT:

- Must have at least 5 Electrical DC Motors
- Must have in build electronical weighting scale with 4 load Cell
- Filled with viscolastic foam
- The rear and other open areas covered with ABS
- Leg angle from 0° to 40° (prodhuesi me te cilin ka ofertuar OE i rekomanduar e ka 30°)
- Spread surface 210 x 100 cm (gjeresia e shtratit eshte kerkuar 100 cm ndersa prodhuesi me te cilin ka ofertuar OE i rekomanduar ka te deklaruar gjeretin e shtratit 60 cm)
- Diameter of the wheel about 125mm (ndersa prodhuesi me te cilin ka ofertuar OE i rekomanduar ka te deklaruar 10cm)
- Width 100cm (gjeresia e shtratit eshte kerkuar 100cm ndersa prodhuesi me te cilin ka ofertuar OE i rekomanduar ka te deklaruar 60cm)

Prove: Dëshmi nga Katalogu i prodhuesit te publikuar ne web faqe.

Per piken 3 te Lotit 3 – Furnizim me osmoze Reverze prodhuesi Herco ne broshurat qe gjinden ne web faqen e kesaj kompanie nuk i prezenton keto pika:

- Dyshojme se mungojne Certifikatat e Servisereve te Certifikuar ashtu si eshte kerkuar ne piken 7 Standards Safety and Training gjegjesisht ne nenpiken 7.5 ku kerkohen 2 Certifikata te Servisereve me Certifikata Valide.
- Osmoza Reverse nuk posedon monitorin touch screen per operim ashtu si eshte kerkuar.
- Mungon specifikimi i detajzuar i Parafiltrimit me vlera te specifikuara ashtu si eshte kerkuar ne piken 3 Technical Specification gjegjesisht nenpiken 3.1 .
- Mungojne RO Modules
- Mungon pershkrimi i materialit instalues te parafiltrimit: Booster pomp e specifikuar, In line operation installation kit, tank operation installation kit, Option ball valve for tank operation, drain chanél F, Instalation material, additional instalation parts, nuk jane prezantuar vlerat “Permeate Capacity” per: Sand Filter tank, Birm Filter tank, Softener Unit ashtu si jane kerkuar ne Specifikimet e detyrueshme ne FDT.
- Mungojne “Filters for particle filtration: Double filter 20” 50µm, Double filter 20” 10µm, Double filter 20” 5µm, Double filter 20” 1µm.
- Mungojne: Extra PVC-U material (room for WRO), Electro Installation material, Hose for Distribution Loop d25, Intel and outlet connectors for water control, additional instalation parts.
- Mungojne te dhenat per largimin e bakterieve dhe endotoxineve (Bacteria & Endotoxins > 99%).
- Mungon Distributive system of the RO unit needs to be with return line.
- Mungon: The RO unit should have PH tolerance between 2-11.
- Mungon: The RO unit should have reject flow between 1.5 to 20 lit/min.

Mungon: PEX Permate connector Mounting Stainless, MSC – PEX Closure Nipple DN 6 R ¼” 11Mm Stainless, Closure Coupling DN 6 NOZZLE 10MM Stainless MSC – PEX, Drainage Installation with anti-Syphon Trap – PEX

- Dyshojme se mungojne Lista e paisjeve per kalibrim dhe mirembajtje preventive ashtu si eshte kerkuar ne piken 8.2 List of Equipments available for providing calibration and routine Preventive maintenance Support, as per manufacturer documentation service/technical manual.
- Dyshojme se mungon pika 8.4 Log book with instructions for daily, weekly, monthly and quarterly maintenance checklist.

Pretendimi ankimore 3.

Për këtë procedure te prokurimit komisioni vleresues i ofertave ka konsumuar shkelje esenciale te dispozitave ligjore dhe me këto veprime është shkëlur deklarata nen betim e secilit nga anëtarët e komisionit, ku përmes saje është marre pergjegjesia civile dhe pergjegjesia për sanksione penale ne njerën ane dhe ne anen tjetër është vleresuar njëanshëm është rekomanduar për dhënie te kontratës kompani e pa pergjegjeshme ku për këtë fakt është i njoftuar dhe ne dijëni secili nga anëtarët e komisionit vlereues te ofertave, madje me nenin 59, par 1 te LPP-se, pergjegjesia është individuale dhe ne si kompani ne rast te lidhjes se kontratës me oferte te tille te pa pergjegjeshme ne aspekt administrativ dhe aspekt teknik, do ti ndjekim rruget ligjore për te tentim te lidhjes se kontratës se kunderligjeshme dhe pa kurrefare eksperience ne këtë fusheveprimtari.

Kompania e rekomanduar për dhënie te kontratës ne lotet 2 dhe 3 sipas prodhuesve me te ciliet ka ofertuar gjegjesisht sipas katalogjeve dhe broshurave te publikuara ne ueb faqe te tyre tregone kjarë për oferte te pa pergjegjeshme ne aspekt teknik. Mos ofrimi i qasjes, fshehja e dokumentacionit te te njejtë tregon për vlerësim subjektiv dhe tregon qe nuk janë aplikuar dispozitat ligjore te LPP-se përkatësisht nuk i ploteson kerkesat kualifikuese te percaktuara ne dosje te tenderit dhe nuk plotesohen specifikat teknike për produktet dhe paisjet e këtyre dy loteve.

Prandaj ne si operator ekonomik ankues perkes kesaj kerkese për ri shqyrtim kërkohmë nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shendetesise, gjegjesisht nga zyrtar pergjegjës te prokurimit, qe ne kuptim te dispozitave ligjore, ne kuptim te gjendjes faktike dhe provave te prezantuara si me sipër ta nxjerrëni kete:

V E N D I M

I. Te aprovohet ne tërësi si e bazuar kerkesa për ri shqyrtim e OE “Medi Health”llc - Prishtine.

II. Te anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 09.10.2024, si i kunderligjeshem dhe lotet 2 dhe 3 te Anulohen ne tërësi, gjegjesisht te njejtë te Ritenderohen;

Operatori Ekonomik ankues “Medi Health”LLC, për këtë procedur te prokurimit se bashku me këtë kerkese do ta njoftoj Agjencionin për informim dhe Privatesi lidhur me mohimin e qasjes ne dokumente publike dhe do ti ndjekim rruget tjera ligjore lidhur me këtë procedur te prokurimit pasi qe vlereimi ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave është karakterizuar me shkelje esenciale te dispozitave ligjore dhe shkelje te parimeve kryesore për prokurim publik.

8. Dëmet materiale

Nuk ka.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin ankimore te OE ankues:

Në lidhje me kërkesën për rishqyrtim nga Grupit te Operatorëve Ekonomik: Medi Health L.L.C.;Greemed për aktivitetin e prokurimit me titullin "Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën në Podujevë" (Nr. Prokurimi 206-24-8799-1-1-1), e datës 14.10.2024, Autoriteti Kontraktues shqyrtoi me kujdes pretendimet dhe konstaton si ne vijim:

Sa i përket pretendimit të pare ankimor (1): Pretendimi për qasjen ne dokumentacion.

Kërkesën tuaj për qasje në dokumente të klasifikuara si sekret afarist, Neni 11 i LPP-së qartëson se Autoriteti Kontraktues ka detyrimin të respektojë kërkesat për sekret afarist të paraqitura nga operatorët ekonomikë, për sa kohë këto kërkesa plotësojnë kushtet e përshkruara në ligj. Sipas Nenin 68 dhe 69 të LPP-së, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të kërkojnë që informacionet komerciale të mbrohen si sekrete afariste nëse ato përmbushin kriteret ligjore.

Është e rëndësishme të theksohet se **Aneksi 3 - Kërkesa për Sekret Afarist** ka qenë pjesë e ofertës se dorëzuar dhe është respektuar nga Autoriteti Kontraktues. Ky aneks është dorëzuar nga të gjithë operatorët ekonomikë, **përfshirë edhe ju si operator ankues.**

Prandaj, qasja në dokumentet e klasifikuara si sekrete afariste është refuzuar në mënyrë të ligjshme dhe të barabartë për të gjithë operatorët, duke respektuar kërkesat për konfidencialitet sipas ligjit dhe rregulloreve të zbatueshme.

Njëjte sikur OE i rekomanduar edhe ju ne ofertën e juaj keni ofruar Deklaraten per konfidencialitet:

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE Medi Health L.L.C. (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:



*Dokumentet e kompanive qe jane ne konzorcium
Autorizimet e kompanive prodhuese
Certifikatat e kompanive prodhuese
Katalogjet dhe deklaratat*

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë prone publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Dokumentet e permendura me sipër nuk jane prone publike, dhe publikimi i tyre do te mund te shkaktohte dëme financiare per kompanite qe jane ne konzorcium.

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	Medi Health L.L.C.
Adresa e plotë:	Magj, Ferizaj-Prishtine, Gracanice
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Saim Krasniqi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	23.09.2024
Vula:	

Sa i përket pretendimit të dyte ankimor (2): Pretendimi për specifikat teknike te ofertës se rekomanduar.

Në lidhje me këtë pretendim, ju njoftojmë se vlerësimi i ofertave është bere nga profesionist te lamisë, konform kërkesave te AK ne NJK dhe DT, si dhe ofertave te pranuar ne këtë aktivitet.

Oferta e rekomanduar i ka plotësuar kërkesat e AK-MSh, produktet janë konform specifikave, janë kualitative, pjesa dërmuese janë te prodhuesve evropian (Gjermani, Itali, Zvicer, Hungari, vetëm një artikull Sterilizator Plazma x 1 cope është nga Turqia – prodhuesi Eryigit, i njëjtë si prodhuesi ne ofertën tuaj).

Sa i përket pretendimit të trete ankimor (3): Pretendimi për shkelje te supozuara te anëtareve te komisionit vlerësues.

Ne si AK-MSh nuk jemi ne dijeni për këtë gjë, as nuk po ju kuptojmë ne formën qe e keni shkruar këtë pretendim, është dashtë ta specifikoni me sakte kur citoni se komisioni vlerësues "ka konsumuar shkelje esenciale te dispozitave ligjore" dhe me shprehjen "...për këtë fakt është i njoftuar dhe ne dijeni secili nga anëtarët e komisionit vlerësues te ofertave" – nuk kemi ndonjë koment për këtë gjë.

Sidoqoftë ne si AK nuk jemi te interesuar për shkelje, por jemi te interesuar për realizimin e projekteve ne te mire te qytetareve, siç është edhe ky projekt i parapare te realizohet këtë vit dhe me buxhetin e ndare për këtë vit 2024 dhe çdo vonese ne procedura e rrezikon projektin dhe interesin e qytetareve.

Njëkohësisht është mire qe edhe ju si OE ta keni te njëjtën qasje për mos dështimin e projekteve me ankesa pa bazë, përderisa nuk e keni plotësuar Deklaratën nën Betim, ndërsa te reagoni ne fazën e tenderimit kur vëreni ndonjë parregullsi, apo favorizim eventual te specifikave teknike për ndonjë OE te caktuar, meqenëse ne si prokurim edhe mund te mos i dimë specifikat teknike te pajisjeve.

Vlen te theksohet se çmimet per artikujt e ofertes tuaj per Lot 3 jane me vlere saktësisht te njejta me kerkesen per tenderim?! – nderkohe qe vlerat e parashikuara per secilin artikull nuk kane qene ne DT, por vetem si vlere e parashikuar ne total per Lot 3 prej 405,000.00 euro.

Pershkrimi i artikujve ne kerkesen per tenderim:

Furnizimet me Pajisje Mjekësore dhe Inventarit Medicinal për Poliklinikën në Podujevë PARAMASA - LOT3					
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi
1	Aparate për Dializë - HD me të gjitha kyqjet që nevojiten për tu funksionalizuar hapësira për përdorimin e pajisjeve.	Copë	16	15,000.00 €	240,000.00 €
2	Shtretër të HD me tavolinë (set) komplet.	Copë	15	5,000.00 €	75,000.00 €
3	Furnizim me Osmozë Reverze - komplet, kërkohet t'i përmbushë kriteret e prodhimit të ujit të pastër, absolutisht të dejonizuar për dializë. Kapaciteti i Reverzë Osmozës duhet të jetë minimum për 15 aparate të Dializës.	Copë	1	85,000.00 €	85,000.00 €
4	Të bëhet instalimi i të gjithave elementeve që duhet për vendosjen e aparaturave të Hemodializës në dhomën HCV- Hepatitis C virus dhe dhomën me Hepatit B Virus.	Copë	1	5,000.00 €	5,000.00 €
				Total Lot3:	405,000.00 €

Pershkrimi i artikujve te ofertes tuaj:

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE - LOT 3

Furnizimet me Pajisje Mjekësore dhe Inventarit Medicinal për Poliklinikën në Podujevë							
Nr. Art	PËRSHKRIMI I PAJISJEVE	Njësia	Sasia/Copë	Çmimi njësi pa TVSH (€)	TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1	Aparate për Dializë - HD me të gjitha kyqjet që nevojiten për tu funksionalizuar hapësira për përdorimin e pajisjeve.	Copë	16	13,888.88	1,111.12	15,000.00	240,000.00
2	Shtretër të HD me tavolinë (set) komplet.	Copë	15	4,629.63	370.37	5,000.00	75,000.00
3	Furnizim me Osmozë Réverze - komplet, kërkohet t'i përmbushë kriteret e prodhimit të ujit të pastër, absolutisht të dejonizuar për dializë. Kapaciteti i Reverzë Osmozës duhet të jetë minimum për 15 aparate të Dializës.	Copë	1	78,703.70	6,296.30	85,000.00	85,000.00
4	Të bëhet instalimi i të gjithave elementeve që duhet për vendosjen e aparaturave të Hemodializës në dhomën HCV- Hepatitis C virus dhe dhomën me Hepatit B Virus.	Copë	1	4,629.63	370.37	5,000.00	5,000.00
TOTALI i përgjithshëm për Lot 3 (DDP):							€ 405,000.00

Sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK te datës 09.10.2024, oferta juaj eshte eliminuar si e papërgjegjshme administrativisht sepse nuk e keni ofruar **Deklaratën nën Betim** për anëtarin e grupit **Greemed**, mungesa e deklaratës nën betim për të gjithë anëtarët e grupit eshte e pa tejkaluashme - kusht administrativ.

Kjo eshte e rregulluar me UDHËZUESIN Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, **neni 10-sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve**, për mungese te deklaratës nen betim Tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informacione të mëtejshme.

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon Deklarata nën Betim	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Si perfundim, ne qendrojme plotesisht pas Njoftimit mbi Vendimin e AK te datës 09.10.2024, oferta juaj eshte administrativisht e papërgjegjshme dhe e konsiderojmë si pale pa interes ne këtë aktivitet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Berat Marmullaku

Udhëheqës i Div. te Prokurimit